



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 216/4 Prot

Tiranë, më 8. 4.2016

VENDIM

Nr. 12, datë 8. 4.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, klinika "Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana-CDC", me aktivitetin e tij në formën ligjore, person juridik dhe NIPT:K82202004B.

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.38, datë 22.02.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 25.02.2016 e në vazhdim, pranë kontrolluesit si më lart cituar filloi procedura e hetimit administrativ, me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit "Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana (CDC)" sh.p.k., i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, nga grupi i inspektimit është konstatuar: Ky kontrollues, ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2008;

1. Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për njoftim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Kontrolluesi nuk ka rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale, apo dhe ndonjë rubrikë ku të përcaktohen qartë detyrimet dhe të drejtat e kontrolluesit, përpunuesit dhe sidomos të subjektit të të dhënave personale-pacienti. Ka dy rregullore për mbarëvajtjen e aktivitetit të natyrës shëndetësore, të cilat u vunë në dispozicion në vend, por kopjet e tyre nuk u administruan në cilësinë e provës materiale, për të vërtetuar faktin se në to nuk ka asgjë të shkruar për të dhënat personale, pasi përfaqësuesit e kontrolluesit

nuk e lejuan këtë veprim të ligjshëm që konsiston në *ushtrimin e të drejtave dhe detyrave që Zyrës së Komisionerit i ngarkohen me ligj.*

3. Kontrolluesi nuk ka parashikuar në kontratën me punëmarrësit, Deklaratën e Konfidencialitetit.
4. Në marrëdhëniet kontraktuale me të tretët- përpunuesit, kontrolluesi ka të parashikuar, një paragraf konfidencialiteti me palën tjetër, por jo në funksion të mbrojtjes së të dhënave të subjekteve-pacientë, sipas kërkesave ligjore të Udhëzimit Nr.19 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*".

Në përfundim të hetimit administrativ pasi u mbajt procesverbali për konstatimet e gjetura nga ana e grupit të inspektimit, përfaqësuesit e kontrolluesit parashtruan pretendimin: "*Nuk kemi pasur dijeni për ligjin mbi të dhënat personale, megjithatë ne do ti rikuperojmë sa më shpejtë të jetë e mundur shkeljet e konstatuara. Do të përmbushim detyrimet e dala nga ky proces verbal. Do paraqesim gjithë dokumentat e kërkuara*"

Në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, përpara marrjes së vendimit përfundimtar në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në datë 05.04.2016, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët u shprehën se nuk kanë patur dijeni për ligjin, dhe paraqitën dokumentacione që vërtetoin se, pjesa më e madhe e shkeljeve të konstatuara nga grupi i inspektimit administrativ ishin rikuperuar.

Përshkrimi i gjetjeve administrative.

- 1- Kontrolluesi, klinika "*Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana*" sh.p.k., nuk kishte përmbushur detyrimin për "*Njoftimin*", në lidhje me përpunimin e të dhënave pranë zyrës së K.D.I.M.D.P.-së, në shkelje kjo të neneve 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar;
- 2- Kontrolluesi, klinika "*Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana*" sh.p.k., nuk ka një rregullore në lidhje me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, në shkelje kjo të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar;
- 3- Kontrolluesi, klinika "*Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana*" sh.p.k., nuk aplikon deklaratën e konfidencialitetit me punëmarrësit, në shkelje të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar;
- 4- Kontrolluesi, klinika "*Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana*" sh.p.k., nuk aplikon aneks kontratën tip në rastin e delegimit të përpunimit të analizave shëndetësore me palë të treta sipas Udhëzimit Nr.19 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*".

Konstatimet e gjetura konsiderohen në shkelje dhe mosrespektim të kushteve dhe kriterëve që parashikon Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, duke patur parasysh faktin që, kontrolluesi ka një periudhë të gjatë kohore që operon

në mënyrë të paligjshme në përpunimin e të dhënave personale subjekteve të të dhënave, kryesisht pacientë.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 gërmat "d" dhe "dh" të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

d) kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 300 000 lekë.

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 500 000 lekë.

Kontrolluesi, klinika "Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana" sh.p.k., në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me sigurinë e të dhënave personale, detyrimin për informim, si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi, ka reaguar në rikuperimin e shkeljeve, por ka cënuar detyrimin për bashkëpunim, duke mos i siguruar nëpunësve të Zyrës së Komisionerit, gjithë informacionin e kërkuar për përmbushjen e detyrave ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 21, 27, 28, 30, 31, 39/1, gërmat "d" dhe "dh", 39/2 si dhe neneve 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit, klinika "Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana" sh.p.k., me gjobë, në vlerën **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit, klinika "Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana" sh.p.k., me gjobë, në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit, klinika "Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana" sh.p.k., me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

4. Kontrolluesi, klinika "Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana" sh.p.k., domosdoshmërisht të realizojë aneks kontratën tip të konfidencialitetit, sipas Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, për përpunimin e të dhënave personale nga palë të treta, të cilët i pajton për kryerjen e shërbimeve që ata ofrojnë, e për pasojë aksesojnë të dhëna të pacientëve të kontrolluesit.
5. Kontrolluesi klinika "Cardio&Diagnostic Center Hamburg/Tirana" sh.p.k., të rikuperojë shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit brenda një periudhe prej 30 ditësh.
6. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot në, 8 . 4 .2016

